

Këshilla për shëndetin nga FIP

Përhapja e CORONAVIRUS SARS-CoV-2:
Informacion dhe udhëzime të
përkohshme për farmacinë dhe farmacistët

FEDERATA FARMACEUTIKE NDËRKOMBËTARE

Përhapja e koronavirus SARS-CoV-2:

Informacion dhe udhëzime të përkohshme për farmacinë dhe farmacistët

FIP do të përditësojë këtë udhëzues pasi më shumë informacione të bëhen të disponueshme.

Tabela e përmbajtjes

<u>Qëllimi i këtij dokumenti</u>	3
<u>Përgjegjësitë dhe roli i farmacisë në komunitet</u>	3
<u>Përgjegjësitë dhe roli i farmacisë spitalore</u>	3
Përhapja e koronavirusit	3
<u>Çfarë është një koronavirus?</u>	3
<u>Çfarë është përhapja e koronavirusit SARS-CoV-2?</u>	4
<u>Si transmetohet koronavirusi SARS-CoV-2?</u>	4
<u>Si NUK transmetohet koronavirusi SARS-CoV-2?</u>	5
<u>SARS-CoV-2 Sëmundja akute e frymëmarrjes - informacion klinik</u>	5
<u>Fillimi</u>	5
<u>Simptomat</u>	5
<u>Trajtimi</u>	5
<u>Sigurimi i barnave kryesore, pajisjeve dhe strukturave</u>	6
<u>Parandalimi</u>	6
Aktivitetet e ndërmjetësuara nga farmacia	7
<u>Masat parandaluese</u>	7
<u>Rekomandime për kujdesin ambulator</u>	9
<u>Shfaqja / Trajtimi</u>	9
<u>Referimi dhe izolimi</u>	10
<u>Trajtimi në shtëpi për pacientët e dyshuar me infeksion SARS-CoV-2 që paraqesin simptoma të lehta</u>	10
<u>Farmacia si burim informacioni</u>	10
<u>Testimi laboratorik për rastet e dyshuara me SARS-CoV-2</u>	11
<u>Kontrolli i infeksionit: larja dhe fërkimi i duarve</u>	11
<u>Si të përgatisni formulimet me bazë alkooli për fërkimin e duarve</u>	11
<u>Menaxhimi i pastrimit dhe dezinfektimit</u>	11
<u>Kontrolli i infeksionit: masa paraprake të tjera</u>	12
<u>Shqetësimet lehtësuese: udhëtimi</u>	12
<u>Stafi i farmacisë</u>	13
<u>Përgjigje për pyetje të shpeshta nga publiku dhe pacientët</u>	13
<u>Shpërhapja e mitit</u>	15
<u>Burime dhe informacione shtesë</u>	17
<u>Bibliografia</u>	17
<u>Burime dhe informacione të tjera</u>	19
<u>Vlefshmëria</u>	21

SHTOJCA 1: Lista e barnave kryesore për trajtimin e infeksioneve SARS-CoV-2	22
<u>SHTOJCA 2: Lista e strukturave kryesore, pajisjeve dhe pajisjeve mbrojtëse personale për infeksionet SARS-CoV-2</u>	<u>23</u>
SHTOJCA 3: Vendimet për këshillat e farmacistëve në komunitet	24
<u>SHTOJCA 4: Udhëzuesi i OBSH-së për formulimin e produkteve të ndryshme për duart.....</u>	<u>25</u>
<u>SHTOJCA 5: Lista e dezinfektuesve për objektet që zakonisht kontaminohen nga infeksionet SARS-CoV-2</u>	<u>28</u>
<u>Mirënjohtë</u>	<u>29</u>

Qëllimi :

Sigurimi i informacionit dhe direktivave përkatëse mbi përhapjen e koronavirusit (SARS-CoV-2) për farmacistët, që punojnë në farmacitë e rrjetit të hapur, institucionet e kujdesit shëndetësor dhe në mjediset e spitaleve e gjithashtu dhe për farmacistët që punojnë si biologë klinikë në laboratorët e analizave mjekësore, dhe ofrojnë një seri referencash që mund të konsultohen për një informacion më të zgjeruar.

Infeksionet me koronavirus mund të parandalohen si dhe mund të ndalohet përhapja masive me përfshirjen aktive të profesionistëve të kujdesit shëndetësor, mediat dhe komunitetin, siç është dëshmuar në shpërthimet e mëparshme të koronavirus, siç është në 2003 me SARS-CoV (Severe Acute Respiratory Syndrome Coronavirus) (Sindroma Akute Respiratore nga Coronavirus) ose në vitin 2012 me MERS-CoV (Sindroma Respiratore në Lindjen e Mesme nga Coronavirus). Ky dokument synon të ndihmojë farmacistët në parandalimin e përhapjes së sëmundjes dhe të kontribuojë në menaxhimin e saj efikas në sistemin e kujdesit shëndetësor

Përgjegjësitë dhe roli i farmacistëve të rrjetit të hapur:

Farmacitë e rrjetit të hapur në vendet e prekura dhe të paprekura nga virusi, janë shpesh pika e parë e kontaktit me popullatën që ka shqetësime shëndetësore, ose me ata që thjesht kanë nevojë për informacion dhe këshilla të besueshme.

Farmacitët e rrjetit të hapur kanë përgjegjësinë e përbashkët për:

- Ruajtjen e stokeve të nevojshme të produkteve farmaceutike (barna, maska, etj) për të plotësuar kërkesën.
- Informimi dhe edukimi i popullatës.
- Këshillimi
- Referencat
- Promovimi i parandalimit të sëmundjes
- Promovimi i kontrolleve për infeksionin

Përgjegjësitë dhe roli i farmacistëve spitalorë

Farmacitë spitalore në vendet e prekura dhe të paprekura luajnë një rol të rëndësishëm në:

- Ruajtjen e stokeve të nevojshme të barnave përkatëse, produkteve dhe pajisjeve të tjera mjekësore për të plotësuar kërkesat
- Bashkëpunim me profesionistë të tjerë të kujdesit shëndetësor për ofrimin e një shërbimi shëndetësor të përshtatshëm ndaj pacientit
- Parandalimi dhe kontrolli i infeksionit në kushtet spitalore
- Informimi dhe këshillimi
- Sigurimi i përdorimit të përgjegjshëm të produkteve farmaceutike. Për shembull, duke siguruar që profesionistët e kujdesit shëndetësor i veshin vazhdimisht maskat e tyre në mënyrë korrekte.

Përhapja e koronavirusit

Cfarë është një koronavirus?

Koronaviruset (CoVs) janë një familje e madhe e virusesh që shkaktojnë sëmundje si të ftohtë të zakonshme duke kaluar në sëmundje më të rënda si [Middle East Respiratory Syndrome \(MERS- CoV\)](#) dhe [Severe Acute Respiratory Syndrome \(SARS-CoV\)](#). [A novel coronavirus \(nCoV\)](#) është një lloj i ri që nuk është identifikuar më parë tek njerëzit.

Koronaviruset janë zoonotikë, që do të thotë që ato transmetohen midis kafshëve dhe njerëzve. Hetimet e hollësishme zbuluan se SARS-CoV ishte transmetuar nga macet tek njerëzit dhe MERS-CoV nga devetë tek njerëzit. Disa koronaviruset të njohura po qarkullojnë te kafshët por nuk kanë infektuar ende njerëzit

Koronaviruset janë viruse të mëdha, të mbështjella dhe me ARN sens-pozitive. Ata kanë gjenomin më të madh midis të gjitha ARN viruseve. Gjenomi është i pakeluar brenda një kapsidi spiral të formuar nga proteina e nukleokapsidit dhe më tej rrethohet nga një mbështjellë. Të shoqëruar me mbështjelljen virale janë të paktën tre proteina strukturore: proteina e membranës dhe proteina e mbështjelljes të cilat janë të përfshira në përbërjen e virusit, ndërsa proteina S ndërmjetëson hyrjen e virusit në qelizat pritëse. Në mesin e proteinave strukturore, proteina S formon zgjatime të mëdha nga sipërfaqja e virusit, duke i dhënë koronavirusit pamjen e të pasurit kurorë (pra emri i tyre; *korona* në latinisht do të thotë kurorë). (Li, 2016)

Koronaviruset zakonisht prekin gjitarët dhe zogjtë, duke shkaktuar një sërë sëmundjesh vdekjeprurëse. Në përgjithësi, koronaviruset shkaktojnë sëmundje të përhapura të sistemit respirator, gastrointestinal dhe të sistemit nervor qendror tek njerëzit dhe kafshët e tjera, duke kërcënuar shëndetin e njeriut. (Li, 2016)

Koronaviruset janë të aftë të përshtaten me lehtësi në mjedise të reja përmes mutacioneve apo rekombinimeve të cilat ndodhin lehtësisht. (Li, 2016) Në këtë mënyrë, ato mund të prekin qeliza dhe inde të reja.

Për këtë arsye, megjithëse rrallë, disa koronaviruset që zakonisht prekin vetëm specie të caktuara kafshësh mund të gjenerojnë lloje të reja të cilat mund të kalojnë tek njerëzit e më pas të shpërndahet ndërmjet tyre. Meqënëse njerëzit nuk kanë qenë më parë të ekspozuar ndaj viruseve të tillë dhe nuk mund të mbroheshin me vaksinat ekzistuese apo imuniteti natyror, këto mutacione mund të çojnë shpejt në shpërthim sëmundjesh dhe si rrjedhojë, në pandemi. Kështu ndodhi me shpërthimet e mëparshme të SARS dhe MERS.

Cfare është përhapja e koronavirusit SARS-CoV-2?

SARS-CoV-2 është një lloj i ri i koronavirusit që u zbulua së pari në qytetin Wuhan, në provincën e Hubei, në Republikën Popullore të Kinës - një qytet me një popullsi prej 11 milion banorë. Përhapja filloi si një pneumoni e shkaktuar nga një agjent i panjohur në fund të dhjetorit 2019.

Më 30 Janar 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli gjendjen e Emergjencës së Shëndetit Publik me shqetësim ndërkombëtar. OBSH rekomandoi që emri i përkohshëm i sëmundjes të jetë sëmundja akute e frymëmarrjes 2019-nCoV. Në akronimin 2019-nCoV, "2019" është viti kur u zbulua për herë të parë virusi, "n" do të thotë "i ri", dhe "CoV" korrespondon me familjen koronavirus.

Më 11 shkurt 2020, OBSH më në fund vendosi ta emërojë virusin **severe acute respiratory syndrome coronavirus 2 (sindromë e rëndë akute e frymëmarrjes koronavirus 2) (SARS-CoV-2)**, dhe sëmundjen e shkaktuar nga ky virus si **COVID-19** (për Coronavirus disease të identifikuar në 2019).

Si transmetohet koronavirusi SARS-CoV-2?

Transmetimi i SARS-CoV-2 ndodh me mekanizmat e mëposhtëm:

- Më shpesh, përhapet nga personi në person midis kontakteve të afërta (rreth 6 metra / 1,8 metra).
- Përhapja nga personi në person mendohet të ndodhë kryesisht përmes spërklave të frymëmarrjes të prodhuara kur një person i infektuar kollitet ose teshtin, të ngjashme me mënyrën se si përhapet gripi dhe patogjenët e tjerë të frymëmarrjes.
- Këto spërklava mund të vendosen në gojën, hundën ose sytë e njerëzve që janë afër ose mund të depërtojnë në mushkëri.
- Aktualisht është e paqartë nëse një person mund të marrë SARS-CoV-2 duke prekur një sipërfaqe ose objekt që ka virusin në të (fomitët) dhe më pas të prekë gojën, hundën apo sytë.
- Për shumicën e viruseve respiratore, mendohet që personat me më shumë simptoma të sëmundjes janë ata që kanë dhe probabilitetin më të lartë që të infektojnë të tjerët. Sidoqoftë, me SARS-CoV-2, ka pasur raporte për përhapjen e virusit nga një pacient i infektuar josimptomatik tek një tjetër jo i infektuar nëpërmjet një kontakti fizik. (Centers for Disease Control and Prevention, 2020) (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020) (Rothe, 2020)

Si nuk transmetohet koronavirusi SARS-CoV-2 ? Edhe pse njohuritë për koronavirusin e ri janë akoma të kufizuara, NUK ka të ngjarë që transmetimi të mund të ndodhë nga:

- a. Objektet ose sipërfaqet e kontaminuara ose të ekspozuara ndaj virusit, pas një periudhe të shkurtër kohe. Shqetësimet në lidhje me pakot apo materialet e dërguara nga zonat e prekura me virusin janë shumë të pabazuara, duke marrë parasysh kohën që kërkojnë pako të tilla për të arritur në destinacionin e tyre. Thënë kjo, ende nuk ka prova në lidhje me qëndrueshmërinë e virusit mbi sipërfaqe dhe objekte të ndryshme.
- b. Ushqime të gatuar mirë dhe të përgatitura siç duhet.

SARS-CoV-2 Sëmundja respiratore akute - informacion klinik

Fillimi

SARS-CoV-2 ka një periudhë inkubacioni 2 deri 14 ditë perpara fillimit të simptomave.

Shënim : Nëse një person është ekspozuar ndaj virusit, por nuk ka zhvilluar simptoma brenda

14 ditëve, ai mund të konsiderohet si i painfektuar.

Simptomat

Për infeksione të konfirmuara me SARS-CoV-2, shfaqjet e sëmundjes të raportuara kanë qenë nga njerëzit me pak ose aspak simptoma deri tek njerëzit me simptoma të rënda dhe deri në vdekje. Simptomat mund të përfshijnë (pas shtrimit në spital) (Nanshan Chen, 2020):

- Ethe (> 80% e pacientëve)
- Kollë (> 80%)
- Probleme me frymëmarrjen (31%)
- Dhimbje muskulare (11%)

Sëmundja mund të shfaqet me simptoma të lehta, duke përfshirë: ethe të shkallës së ulët, kollë, mungese fuqie, rinorre, dhimbje të fytit pa ndonjë shenjë paralajmëruese, të tilla vështirësi në frymëmarrje, sekrecione të shtuara në rrugët e frymëmarrjes (p.sh. sputum ose hemoptizë), simptoma gastrointestinale të tilla si nauze, të vjella dhe / ose diarree dhe pa ndryshime në gjendjen mendore (si konfuzion, letargji). (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Të dhënat paraprake raportojnë një vdekshmëri prej 11% midis pacientëve të shtruar në spital. Ka pasur komplikime në 33% të pacientëve, dhe ka përfshirë: Sindromën akute të crregullimit të frymëmarrjes (ARDS) (17%), dëmtim akut renal, dëmtim akut respirator, shok septik dhe pneumoni. (Nanshan Chen, 2020)

Faktorët e rrezikut për një shfaqje të rëndë të sëmundjes nuk janë ende të qarta, megjithëse pacientë të moshuar ose pacientë me sëmundje të tjera shoqëruese (si p.sh. diabeti, hipertensioni, sëmundje kardiovaskulare kanceri) mund të jetë në rrezik më të lartë. Në rastet më të rënda, infeksioni mund të shkaktojë pneumoni, Sindromi respirator të rëndë akut, insuficiencë renale dhe madje edhe vdekje. (Organizata Botërore e Shëndetësisë 2020)

Trajtimi

Aktualisht, nuk ka asnjë bar ose vaksinë specifike për koronavirus SARS-CoV-2 dhe asnjë bar apo vaksinë të testuar plotësisht për sigurinë dhe efikasitetin. Që nga momenti që autoritetet shëndetësore kineze e shpërndanë masivisht informacionin mbi gjenomin e virusit me komunitetin ndërkombëtar më 10 janar 2020, disa ekipe kërkimore janë përpjekur të zhvillojnë vaksina dhe trajtime. Sidoqoftë, do të kalojë ca kohë para se trajtime të tilla ose vaksina të jenë në dispozicion.

Trajtimi specifik mund të përfshijë Remdesivir Intravenoz (një produkt i ri në zhvillim analog i nukleotideve) i cili është testuar në pacientët e parë të hospitalizuar në SHBA (Michelle L. Holshue, 2020) dhe në Francë (të dhëna të pabotuara).

Për një gjykim më të plotë mbi mundësitë e ndryshme të trajtimit, si dhe udhëzime për trajtimin e popullsisë të veçanta (pacientë shtatzënë, të porsalindur, fëmijë dhe të rinj) dhe mbi informacione mbi ushqyrjen, shihni dokumentin udhëzues (në gjuhën angleze dhe gjuhën kineze) të përgatitur nga Shoqata Farmaceutike Kineze, gjithashtu në dispozicion në [dedicated FIP webpage](#). (Shoqata Farmaceutike Kineze, 2020 (12 Shkurt))

Sigurimi i stokut të barnave, strukturave dhe pajisjeve mjekësore:

Duke synuar parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve SARS-CoV-2, farmacitë duhet të garantojnë furnizimin me barna, duke patur parasysh ato të përdorura për parandalimin e sëmundjeve, diagnostikimin dhe trajtimin, si dhe për sigurimin e ekipeve ndihmëse mjekësore.

Farmacitë duhet të caktojnë një farmacist që të marrë përsipër blerjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e barnave kryesore, dhe të rregullojë inventarin sipas nevojës për të garantuar furnizimin.

Lista përfshin barna antivirale, agjentë antimikrobikë, antipiretikë dhe analgjezikë, kortikosteroide dhe disa kategori të tjera të barnave. Shihni tabelën e formularit nga Shoqata Farmaceutike Kineze në [Annex 1](#).

Për një listë të faciliteteve kryesore, pajisjeve dhe mjeteve mbrojtëse personale, të renditura përsëri nga Shoqata Farmaceutike Kineze, shihni [Annex 2](#).

Parandalimi

Për të kontrolluar përhapjen e virusit, njerëzit që dyshohen ose konfirmohen se janë të sëmurë duhet të izoloohen nga pacientët e tjerë dhe të trajtohen nga punonjësit e shëndetit duke përdorur masa të rrepta të kontrollit të infeksionit.

Njerëzit të cilët kanë pasur kontakte sociale me individë simptomatikë të konfirmuar me infeksion SARS-CoV-2 duhet të ndiqen nga ekipet lokale të kujdesit shëndetësor.

Rekomandimet standarde të OBSH-së drejtuar publikut të gjerë për të zvogëluar ekspozimin dhe transmetimin e këtij virusi dhe sëmundjeve të tjera respiratore janë si më poshtë, ato përfshijnë higjienën e duarve dhe atë respiratore, dhe ushqyerjen e sigurtë:

1. Pastroni duart shpesh duke përdorur produkte me bazë alkooli ose sapun dhe ujë;
2. Kur kolliteni dhe teshtini, mbulon gojën dhe hundën me bërryl ose facoletë - hidhni facoletën menjëherë dhe lani duart;
3. Shmangni kontaktin fizik me këdo që ka ethe dhe kollë;
4. Nëse keni ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje kërkoni trajtim mjekësor menjëherë dhe ndani historinë me të fundit të udhëtimit me mjekun ose me një person tjetër të stafit shëndetësor;
5. Kur vizitoni tregjet në zonat që aktualisht kanë raste të koronavirusit të ri, shmangni kontaktin e drejtpërdrejtë me kafshë të gjalla dhe sipërfaqje që janë në kontakt me kafshët;
6. Duhet të shmangët konsumimi i produkteve shtazore të papërpunuara ose të papjekura mire. Mishi i papërpunuar, qumështi ose organet e kafshëve duhet të trajtohen me kujdes, për të shmangur kontaminimin. Kjo sipas praktikave të mira të sigurisë ushqimore. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Vetë-izolim nga persona me simptoma dhe / ose persona që mund të kenë qenë në kontakt me persona të infektuar

Vetë-izolimi nënkupton shmangjen e situatave ku mund të infektohen njerëzit e tjerë. Kjo do të thotë të gjitha situatat kur mund të kontaktoni me të tjerët, siç janë eventet sociale, vendi i punës, shkollat, qendrat e kujdesit për fëmijët / parashkollorët, universitetet, organizimet fetare, institucionet e kujdesit për të moshuarit dhe qendrat e kujdesit shëndetësor, burgjet, eventet sportive, supermarkete, restorante, qendra tregtare dhe të gjitha grumbullimet publike. (Ministria e Shëndetësisë e Zelandës së Re, 2020)

Aktivitetet e ndërmjetësuar nga farmacia

Shihni gjithashtu [Annex 3](#) – Këshillimet për farmacistë e rrjetit të hapur

Masat parandaluese

Farmacisti mund të luajë një rol kryesor në parandalimin e përhapjes së koronavirusit SARS-CoV-2 duke:

- Kuptuar natyrën e sëmundjes, si transmetohet dhe si ta parandalojmë atë të përhapet me tej ;
- Të kesh në dispozicion burimet e informacionit të nivelit kombëtar në lidhje me strategjitë kundër SARS-CoV-2 (përfshirë qendrën më të afërt të referimit për SARS-CoV-2), dhe ta perditësosh këtë informacion;
- Informimi, këshillimi dhe edukimi i komunitetit;
- Furnizimi me produkte të përshtatshme;
- Inkurajimi i individëve dhe familjeve që dyshohen të jenë të infektuara me virusin për të kërkuar trajtim nga institucionet e kujdesit shëndetësor që posedojnë mjedisin dhe pajisjet e përshtatshme për të menaxhuar pacientë të tillë. Qendrat e kujdesit parësor, farmacistë ose objektet e tjera të kujdesit shëndetësor (përfshirë ato të mjekësisë tradicionale) mund të luajnë një rol kryesor në parandalimin e sëmundjes, por ato nuk kanë strukturat dhe pajisjet e duhura për të trajtuar ose menaxhuar SARS-CoV -2. Përpjekja për të trajtuar pacientët në mjedise joadekuata mund të rrezikojë profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të tjerët.

Për më tepër, masat e mëposhtme duhet të merren parasysh nga menaxhuesit e farmacistë (Shoqata Farmaceutike Kineze, 2020 (12 Shkurt)):

1. Zhvilloni plane emergjence dhe plane për fluksin në punë
2. Kryeni trajnime të plota për personelin
3. Përqendrohuni në gjendjen shëndetësore të farmacistëve
4. Mbron personelin e farmacistë
5. Forconi monitorimin e infeksionit nga farmacistët
6. Siguroni një menaxhim adekuat të pastrimit dhe dezinfektimit
7. Forconi menaxhimin e pacientit
8. Shtoni informimin e pacientëve
9. Forconi menaxhimin e ekspozimit ndaj infeksionit
10. Përforsim i menaxhimit të mbetjeve mjekësore

Udhëzimi i detajuar për secilën pikë jepet nga Shoqata Kineze Farmaceutike në dokumentin e duhur që mund të gjendet në [FIP dedicated webpage](#).

Përdorimi i maskave

Vendosja e një maskë mjekësore është një nga masat parandaluese për të kufizuar përhapjen e disa sëmundjeve të frymëmarrjes, përfshirë SARS-CoV-2. Sidoqoftë, përdorimi i vetëm i maskës është i pamjaftueshëm për të siguruar mbrojtjen e duhur, duke shtuar faktin që duhet të merren masa të tjera po aq të rëndësishme.

Nëse do të përdoren maska, kjo masë duhet të kombinohet me sigurimin e higjenes së duarve dhe masat e tjera të kontrollit të infeksionit dhe parandalimit të transmetimit të SARS-CoV-2 nga njeriu tek njeriu.

OBSH rekomandon që punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet:

- Vendosni një maskë mjekësore kur hyni në një dhomë ku ka pacientë të dyshuar ose të konfirmuar me SARS-CoV-2;
- Përdorni një përthithës të grimcave të paktën po aq mbrojtës sa ai i vendosur nga (NIOSH) (Instituti Kombëtar i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë), si psh. N95, që plotëson standardet e Bashkimit Evropian (BE) FFP2, ose një lloj tjetër ekuivalent në rastet kur kryeni procedura me aerosol, të tilla si intubimi trakeal, ventilimi jo-in vaziv, trakeotomia, ringjallja kardiopulmonare, ventilimi manual para intubacionit dhe bronkoskopisë.

Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në SHBA (CDC) ka nxjerrë udhëzime për tre faktorët kryesorë që një pajisje e tillë të jetë efektive:

:

1. Respiratori duhet të vendoset në rregull dhe duhet të jetë i veshur gjatë ekspozimit.
2. Respiratori duhet të përshtatet mirë në fytyrën e përdoruesit për të siguruar që të mos ketë boshllëqe midis lëkurës së tij dhe tubit thithës.
3. Filtri i respiratorit duhet të kapë më shumë se 95% të grimcave të ajrit që kalojnë nëpër të. (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve)

Për udhëzime për përdorimin e saktë (dhe të pasaktë), shihni [CDC brochure](#).

Këshilla për komunitetin

Individët pa simptoma të problemeve të frymëmarrjes duhet:

1. Shmangni organizimet e mëdha dhe hapësirat e mbyllura me njerëz;
2. Mbani një distancë prej të paktën 1 metër nga çdo individ me simptoma të SARS-CoV-2 (p.sh., kolla, teshtitja);
3. Kujdesuni shpesh për higjenën e duarve, duke i pastruar me alkool nëse nuk janë të ndotura dukshëm ose sapun dhe ujë kur duart janë të ndotura dukshëm;
4. Nëse kolliteni ose teshtini mbulonni hundën dhe gojën me brrylin e përthyer ose facoletë, e më pas hidheni facoletën menjëherë pas përdorimit dhe lani duart;
5. Shmangni prekjën e gojës, hundës dhe syve para se të lani duart.

Përdorimi i maskës mjekësore nuk kërkohet, pasi nuk ka prova për dobinë e saj në mbrojtjen e personave jo të sëmurë. Nëse maskat përdoren duhet të ndiqen praktikatat e mira të përdorimit se si të vihen, hiqen dhe depozitohen dhe gjithashtu të ruhen kushtet e higjenës së duarve pas heqjes (shihni më poshtë këshillat në lidhje me menaxhimin e duhur të maskave).

Individët me simptoma respiratore duhet:

1. Të vendosin një maskë mjekësore dhe të kërkojnë kujdes mjekësor nëse kanë ethe, kollë dhe vështirësi në frymëmarrje, sa më shpejt të jetë e mundur ose në përputhje me protokollet lokale;
2. Ndiqni këshillat më poshtë në lidhje me menaxhimin e duhur të maskave.

Vendosja e maskave mjekësore, kur nuk gjykohet e nevojshme mund të shkaktojë kosto të tepërta, krijon një ndjenjë të rremë të sigurisë që mund të çojë në neglizhimin e masave të tjera thelbësore, siç janë praktikatat e ruajtjes së higjenës së duarve. Për më tepër, duke përdorur një maskë në mënyrë të gabuar mund të pengohet efektiviteti i tij në zvogëlimin e rrezikut të transmetimit. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020).

Udhëzime shtesë mund të gjenden në [Interim Infection Prevention and Control Recommendations for Patients with Confirmed 2019 Novel Coronavirus \(2019-nCoV\) or Patients Under Investigation for 2019-nCoV in Healthcare Settings](#). (Centers for Disease Control and Prevention, 2020)

Rekomandime për kujdesin ambulant:

Parimet themelore të parandalimit, mbajtjes në kontroll të infeksionit dhe masat paraprake standarde duhet të zbatohen në të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, përfshirë kujdesin ambulator dhe kujdesin parësor. Për infeksionin SARS-CoV-2, masat e mëposhtme duhet të zbatohen:

- Triazhi dhe evidentimi i hershëm;
- Vënia e theksit mbi zbatimin e higjenës së duarve, higjenës së frymëmarrjes dhe maskave mjekësore që duhen përdorur nga pacientët me simptoma problematike respiratore;
- Përdorimi i duhur i masave parandaluese ndaj kontakteve fizike dhe spërklave për të gjitha rastet e dyshuara;
- Priorizimi i kujdesit për pacientët simptomatikë;
- Kur pacientëve simptomatikë u kërkohet të presin, sigurohuni që ata të kenë një zonë të veçantë të pritjes;
- Edukoni pacientët dhe familjet për njohjen e hershme të simptomave, masat paraprake themelore që duhet të përdoren dhe në cilin institucion të kujdesit shëndetësor duhet të drejtohen. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Shfaqja / Përzgjedhja

CDC-të (Centers for Disease Control and Prevention) Qendra për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në Shtetet e Bashkuara rekomandojnë kriteret e mëposhtme për të udhëhequr vlerësimin e pacientëve që dyshohen për SARS-CoV-2 (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020):

Karakteristikat klinike	&	Rreziku epidemiologjik
Ethet ose shenjat / simptomat e sëmundjeve respiratore (p.sh. kollë ose gulçim)	DHE	Cdo person, përfshirë ketu dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor, të cilët kanë pasur kontakte të ngushta me një person të konfirmuar nga laboratorit që është i infektuar me SARS-CoV-2 brenda 14 ditëve nga fillimi i simptomave
Ethet ose shenjat / simptomat e sëmundjeve respiratore (p.sh. kollë ose gulçim)	DHE	Një histori udhëtimi nga Provinca Hubei , në Kinë brenda 14 ditëve nga fillimi i simptomave
Ethet dhe shenjat / simptomat e një sëmundje respiratore (p.sh., kollë ose gulçim) që kërkon hospitalizim	DHE	Një histori udhëtimesh nga Kina brenda 14 ditëve nga shfaqja e simptomave

Pacientët që përputhen me kriteret e një prej tre skenarëve duhet të drejtohen në një qendër të përshtatshme shëndetësore për vëzhgim të mëtejshëm.

Farmacistët që identifikojnë pacientët që përputhen me kriteret të tilla duhet të izolojnë pacientin (shiko pjesën e mëposhtme, "Referencë dhe izolim"), jo t'i ekzaminonë ata fizikisht dhe **menjëherë të** njoftojnë autoritetet e duhura shëndetësore në mënyrë që të merren masat e nevojshme për të siguruar kujdesin ndaj pacientit dhe parandalojnë transmetimin e mëtejshëm.

Individët të cilët nuk ndihen mirë, por nuk kanë të njëjtat simptoma me skenarët e mësipërm, duhet të këshillohen që të qëndrojnë në shtëpi dhe të respektojnë masat e përgjithshme parandaluese të shumicës së infeksioneve respiratore (shiko seksionin e dedikuar më poshtë).

Referimi dhe izolimi

Nëse dyshoni se dikush mund të jetë i infektuar me sëmundjen akute respiratore SARS-CoV-2, inkurajoheni dhe mbështeteni atë për të kërkuar një trajtim të menjëhershëm mjekësor në një institucion të përshtatshëm të kujdesit shëndetësor. OBSH nuk këshillon familjet ose komunitetet që të kujdesen për individët me simptoma të SARS-CoV-2 në shtëpi, përveç rrethanave të përshkruara në seksionin specifik më poshtë.

Për sa i përket rasteve të dyshimta, autoritetet shëndetësore kombëtare, rajonale ose lokale mund të kenë hartuar protokolle të posacme, dhe është e rëndësishme që të njiheni me këto procedura, t'i ndiqni ato dhe të bashkëpunoni për zbatimin e tyre. Kjo mund të përfshijë izolimin, kur është e mundur, të rastit të dyshuar në një dhomë të veçantë dhe thirrjen e menjëhershme për shërbimet e duhura të emergjencës, të cilat duhet të dërgojnë një ekip profesionistësh të trajnuar dhe të mbrojtur në mënyrën e duhur, për të transportuar personin në institucionin e caktuar shëndetësor.

Kjo dhomë izolimi në farmaci duhet të ketë një banjë private, mobilje minimale dhe objekte të nevojshme për rehatinë e personit gjatë pritjes, në mënyrë që të shmanget ndotja e mundshme e sendeve të tilla dhe të mos jetë nevoja për të dekontaminuar më shumë sende sesa është e nevojshme. Pasi personi i dyshuar është transferuar në një institucion të kujdesit shëndetësor të përshtatshëm, dhoma në të cilën pacienti është izoluar dhe çdo zonë potencialisht e kontaminuar (si psh tualeti) duhet të pastrohet / dekontaminohet duke përdorur produkte dhe procedura të posacme. (shiko seksionin specifik në këtë më poshtë).

Kujdesi që tregohet në shtëpi për pacientët që dyshohet të jenë të infektuar por me simptoma të lehta të SARS-CoV-2

OBSH rekomandon që rastet e dyshuara me infeksionin SARS-CoV-2 të izoloohen dhe të monitorohen në mjedisin spitalor për të siguruar cilësinë e kujdesit shëndetësor (në rast se simptomat e pacientëve përkeqësohen) dhe sigurinë e shëndetit publik.

Sidoqoftë, për disa arsye të mundshme, përfshirë situatat kur kujdesi spitalor nuk është i disponueshëm ose i sigurt (p.sh. kapaciteti i kufizuar dhe pamundësia për të përmbushur kërkesën për shërbime të kujdesit shëndetësor), ose në rast të refuzimit për tu shtruar në spital, opsionet alternative (përfshirë shtëpinë e pacientit) mund të merren në konsideratë.

Nëse ekziston një arsye e tillë, pacientët me simptoma të lehta dhe pa sëmundje kronike shoqëruese të tilla si sëmundje të mushkërive ose zemrës, insuficiencë renale, ose kushte imunokompromentuese që i vendosin ata në rrezik më të madh për shfaqjen e komplikimeve, mund të kujdesen në shtëpi.

Për më tepër, pacientët dhe anëtarët e familjes duhet të edukohen që të ruajnë higjienën personale, të marrin masa për të parandaluar infeksionin, se si të kujdesen për anëtarin e familjes i cili dyshohet si i infektuar dhe se si të parandalojnë përhapjen e infeksionit në personat e tjerë që janë në shtëpi. Ata duhet të përmbahen një serie rekomandimesh që mund të gjenden në [guideline](#) specifike nga OBSH.

Farmacia si një burim informacioni

Farmacistët dhe shoqatat e tyre mund të krijojnë materiale informative (posterë, fletëpalosje, faqe në internet, mesazhe elektronike, njoftime për aplikacione, etj) për komunitetin, përfshirë informacionin që përmban ky udhëzim dhe çdo informacion tjetër që mund të jetë i rëndësishëm për nevojat lokale. Ata gjithashtu mund të organizojnë seanca për pyetje dhe përgjigje në komunitet (shkolla, qendra komunitare, etj.).

FIP gjithashtu ka krijuar një poster të vogël që përmban këshillat kryesore që farmacistët mund të japin në raste të ndryshme ([Annex 3](#)).

FIP gjithashtu ka krijuar një faqe në internet ku mund të aksesohen këto materiale dhe burime të tjera. Ju lutemi vizitoni www.fip.org/coronavirus vazhdimisht që të përditësoheni. Përveç materialeve të FIP (disponibel në gjuhë të ndryshme) kjo faqe interneti përmban dokumente udhëzuese të hartuara nga Shoqata Kineze Farmaceutike në gjuhën angleze dhe kineze.

Përveç këtyre burimeve, ju mund të gjeni një përmbledhje të gjerë të komunikimeve në internet në gjuhë të ndryshme, të listuara në seksionin e [Other resources and information](#).

Testimi laboratorik për SARS-CoV-2 te personat e dyshuar

Për farmacistët që punojnë në laboratorët e biologjisë klinike që mund të përfshihen në testimin diagnostik të mostrave nga rastet e dyshuara humane, OBSH ka zhvilluar një udhëzues të përkohshëm që mund të gjendet [here](#). Laboratorët duhet të jenë veçanërisht të kujdesshëm që të dërgojnë, ose të ofrojnë udhëzimet e duhura për profesionistët në dërgimin e mostrave në laboratorët e zgjedhur të vendeve të tyre, dhe të marrin informacion rreth tyre tek autoritetet kompetente kombëtare. OBSH mund të ndihmojë shtetet anëtare në identifikimin e laboratorëve që janë në gjendje për të siguruar këtë mbështetje.

Udhëzime shtesë mund të gjenden në faqen e internetit të [USA Centers for Disease Control and Prevention – Interim Guidelines for Collecting, Handling, and Testing Clinical Specimens from Patients Under Investigation \(PUIs\) for 2019 Novel Coronavirus \(2019-nCoV\)](#). (Centers for Disease Control and Prevention, 2020)

Kontrolli i infeksionit: larja e duarve dhe fërkimi i duarve

Farmacitë mund të luajnë një rol të rëndësishëm në shëndetin publik duke rritur ndërgjegjësimin në lidhje me rëndësinë e larjes së shpeshtë dhe të përshtatshme të duarve dhe duke furnizuar ose përgatitur vetë disinfektantin e duarve me bazë alkoolin.

Higjiena e duarve është thelbësore për të parandaluar përhapjen e virusit, duhet të kryhet duke aplikuar [correct technique recommended by the WHO](#) dhe duke përdorur sapun dhe ujë të rrjedhshëm ose një disinfektues duarsh me bazë alkoolin.

OBSH rekomandon që formulimet e disinfektuesit të duarve, të kenë një përmbajtje alkooli prej 80% etanol ose 75% alkool izopropil.

Si të përgatisni formulimet me bazë alkooli

Për informacion të detajuar se si të përgatisni disinfektantët e duarve, duke përfshirë metodat e llogaritjes dhe formulimit dhe një udhëzues hap pas hapi për prodhuesit vendor, referojuni *Udhëzuesit të OBSH-së për Prodhimin Lokal: Formulimet e per higjienën e duarve të rekomanduara nga OBSH*, të cilat ne i paraqesim në këto udhëzime për ti gjetur me lehtë ([Annex 4](#)).

Dokumenti është gjithashtu në dispozicion në:
https://www.who.int/gpsc/5may/Guide_to_Local_Production.pdf

Menaxhimi i pastrimit dhe dezinfekti mit

Për shkak se SARS-CoV-2 mund të transmetohet përmes sperklave dhe kontaktit, çdo zonë e spitalit ose mjedisit në farmaci që mund të ketë qenë i kontaminuar me virusin duhet të dezinfektohet. Studimet e mëparshme mbi SARS CoV dhe MERS-CoV sugjerojnë që SARS-CoV-2 është i ndjeshëm ndaj rrezatimit UV dhe nxehtësisë (56°C për 30 minuta). Gjithashtu, dezinfektuesit e mëposhtëm mund të caktivizojnë në mënyrë efektive SARS-CoV-2: eter, 75% etanol, dezinfektues që përmbajnë klor, acid peracetik dhe kloroform. Klorheksidina nuk mund të caktivizojë në mënyrë efektive SARS-CoV-2.

Stafi i farmacistë duhet të pastrojë dhe dezinfektojnë mjedisin e punës, artikujt dhe pajisjet, në përputhje me udhëzimet dhe rregulloret përkatëse të pastrimit dhe dezinfektimit. (Shoqata Farmaceutike Kineze, 2020 (12 Shkurt))

Për një listë të dezinfektuesve dhe aplikimin e tyre në objektet e kontaminuara, shihni [Annex 5](#).

Kontrolli i infeksionit: masa paraprake të tjera:

1. Higjiena e frymëmarrjes duhet të praktikohet nga të gjithë, veçanërisht personat e sëmurë, në çdo kohë. Higjiena e frymëmarrjes i referohet mbulimit të gojës dhe hundës gjatë kollitjes ose teshtitjes duke përdorur maska mjekësore, maska lecke, facoletave dhe brrylin e përkulur, të ndjekur nga higjiena e duarve.
2. Hidhni materialet e përdorura për të mbuluar gojën ose hundën ose pastrojini ato siç duhet pas përdorimit (p.sh. lani shamine duke përdorur sapun ose pastrues dhe ujë).
3. Shmangni kontaktin e drejtpërdrejtë me lëngjet trupore, veçanërisht sekrecione të gojës ose të frymëmarrjes dhe jashtëqitje. Përdorni doreza një përdorimshe dhe mbroni sytë, për të siguruar kujdes oral dhe respirator edhe në rastet kur trajtoni jashtëqitje, urinë dhe mbeturina. Kryeni procesin e higjenës së duarve para dhe pas heqjes së dorezave.
4. Doreza, facoleta, maska dhe mbeturina të tjera të përdorura nga persona të sëmurë ose në kujdesin e personave të sëmurë duhet të vendosen në një enë në dhomën e personit të sëmurë përpara se të depozitohen me mbeturinat e të tjera shtëpiake.
5. Shmangni llojet e tjera të ekspozimit të mundshëm ndaj personave të sëmurë ose sendeve të kontaminuara në mjedisin e personave të sëmurë (p.sh. shmangni ndarjen e furçave të dhëmbëve, cigareve, enëve të ngrënies, pijeve, peshqirëve, rrobave ose çarçafëve). Enet e guzhines duhet të pastrohen me sapun ose me detergjente dhe ujë pas përdorimit. Si rrjedhojë ato mund të përdoren përsëri dhe nuk nevojitet që të hidhen.
6. Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e prekura shpesh, siç janë tavolinat, shtretërit dhe orenditë e tjera të dhomës së gjumit çdo ditë me dezinfektues të rregullt shtëpiak që përmban zbardhues (1 pjesë zbardhues në 99 pjesë ujë).
7. Pastroni dhe dezinfektoni sipërfaqet e banjës dhe tualetit të paktën një herë në ditë me dezinfektues të rregullt shtëpiak që përmban zbardhues (1 pjesë zbardhues në 99 pjesë ujë).
8. Lani rrobat, mbulesat e shtratit, peshqirët e banjës e të duarve, etj., të personave të sëmurë duke përdorur detergjent lavanderie dhe ujë ose lavatriçe me gradacion 60-90°C me detergjent të zakonshëm shtëpiak dhe me pas thajeni tërësisht. Vendosni rrobat e kontaminuar në një qese rrobash. Mos i tundni rrobat e ndotura. Shtete të ndryshme mund të marrin në konsideratë masa për të siguruar që mbeturinat të depozitohen në një depo sanitare, dhe jo në një depo të hapur të pa monitoruar, gjithmonë kur kjo është e mundur. Mund të nevojiten masa shtesë për të parandaluar ripërdorimin johegienik të dorezave dhe maskave të përdorura, dhe për të shmangur kontaktin e drejtpërdrejtë të lëkurës dhe rrobave me materialet e kontaminuara.
9. Përdorni doreza një përdorimeshe, mbroni sytë dhe vishni veshje mbrojtëse (p.sh. platforma plastike) kur pastroni ose prekni sipërfaqe, veshmbathje ose ndërresa të ndotura me lëngje trupore. Ruani higjenën e duarve para dhe pas heqjes së dorezave. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Udhëtimet

Njerëzit mund të shqetësohen për mundësinë e udhëtimit në të njëjtin aeroplan, anije, autobus ose automjet tjetër të një personi të infektuar me SARS-CoV-2, dhe mund të pyesin farmacistin për këtë.

Eshte e dobishme t'i kujtoni atyre se përhapja e virusit SARS-CoV-2 nga personi në person mendohet se ndodh kryesisht përmes sperklave të frymëmarrjes kur një person i infektuar kollitet ose teshtin, kjo eshte e ngjashme me menyrën si perhapet gripi dhe patogjenët e tjerë të frymëmarrjes. Si e tillë, kjo mund të ndodhë gjatë udhëtimit.

Kështu që, nëse një person ka ethe dhe kollë, duhet të këshillohet të shmangë udhëtimet. Disa vende po marrin masa për të kontrolluar pasagjerët në aeroporte dhe porte me qëllim zbulimin e hershëm të udhëtarëve simptomatikë për vlerësim dhe trajtim të mëtejshëm, dhe kështu parandalojnë perhapjen e sëmundjes duke minimizuar ndërhyrjen në trafikun ndërkombëtar.

Ekzaminimi përfshin: kontrollin e shenjave dhe simptomave (temperature mbi 38°C, kollë); intervistimi i udhëtarëve me simptoma të infeksionit respirator që vijnë nga zonat e prekura; drejtimi i udhëtarëve simptomatikë në ekzaminim të mëtejshëm mjekësor i ndjekur nga testimi për SARS-CoV-2; dhe mbajtja e rasteve të konfirmuara nën izolim dhe trajtim. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

Stafi i farmacistë

Megjithëse është e rëndësishme që i gjithë stafi i farmacistë të jetë i njohur me këto udhëzime dhe këshilla, vlerësimi i rrezikut të një pacienti nga infeksioni SARS-CoV-2 duhet të drejtohet nga farmacistët. Ata janë gjithashtu përgjegjës për referimin e duhur të rasteve të dyshuara në institucionin përkatës të kujdesit shëndetësor dhe autoritetet.

Natyrisht, ekziston mundësia e ekspozimit të farmacistëve ndaj SARS-CoV-2, sepse ato bashkëveprojnë me pacientë që ndoshta janë të infektuar, prandaj punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet të marrin masa për të mbrojtur veten gjithashtu.

Përgjigje për pyetje të shpeshta nga publiku dhe pacientët

Cfarë është një koronavirus i ri?

Një koronavirus i ri (nCoV) është një virus i paidentifikuar më parë. SARS-CoV-2 nuk është i njëjtë me [coronaviruses that commonly circulate among humans](#) dhe shkaktojnë simptoma të lehta, si ftohja e zakonshme. Një diagnozë me koronavirus 229E, NL63, OC43, ose HKU1 nuk është e njëjtë me një diagnozë SARS-CoV-2. Këto janë viruse të ndryshme dhe pacientët me SARS-CoV-2 do të vlerësohen dhe kujdesen ndryshe nga pacientët me diagnozë të zakonshme të koronavirusit. (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

Cili është burimi i SARS-CoV-2?

Zyrtarët e shëndetit publik dhe bashkëpunëtorët e tyre po punojnë shumë për të identifikuar burimin e SARS-CoV-2. Koronaviruset janë një familje e madhe virusesh, disa duke shkaktuar sëmundje të njerëzve dhe të tjerët që qarkullojnë midis kafshëve, përfshirë ketu devetë, macet dhe lakuriqet e nates. Analiza e pemës gjenetike të këtij virusi është në zhvillim e sipër për të përcaktuar burimin specifik të prejardhjes. SARS, një tjetër koronavirus që u shfaq për të infektuar njerëzit, vinte nga macet te llojit Civet, ndërsa MERS vinte nga devetë. (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

Si përhapet virusi?

Ky virus ndoshta fillimisht ka dalë nga një burim shtazor por tani duket se po përhapet nga një person në tjetrin. Është e rëndësishme të theksohet se përhapja nga personi në person ndryshon. Disa viruse janë shumë ngjites (si fruthi), ndërsa viruset e tjerë janë më pak. Në këtë kohë, është e paqartë se sa lehtë ose në mënyrë të vazhdueshme po përhapet SARS-CoV-2 midis njerëzve. (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

A është SARS-CoV-2 i njëjtë me virusin MERS-CoV ose SARS?

Jo. Koronaviruset janë një familje e madhe virusesh, disa duke shkaktuar sëmundje të njerëzve dhe të tjerë që qarkullojnë midis kafshëve, përfshirë devetë, macet dhe lakuriqet e nates. SARS-CoV-2 i shfaqur kohët e fundit nuk është i njëjtë me koronaviruset që shkaktojnë MERS ose SARS. Sidoqoftë, analizat gjenetike sugjerojnë se u përftua nga një virus i lidhur me atë që shkaktoi SARS. Ka hetime në vazhdim për të mësuar më shumë. Kjo është një situatë që po zhvillohet me shpejtësi dhe informacioni do të përditësohet pasi të bëhet i disponueshëm. (Qendrat për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, 2020)

Kam ethe dhe kollë. A mund të jetë koronavirusi i ri?

Nëse keni qenë në Kinë ose në kontakt të ngushtë me një rast të konfirmuar të infeksionit SARS-CoV-2, mund të jetë, dhe ju duhet të kontrolloheni dhe të testoheni. Përndryshe, me siguri nuk është virusi i ri. Në Hemisferën Veriore, tani është sezoni i gripit, kështu që mund të jetë grip.

Cfarë mund të bëj për të mbrojtur veten nga infeksioni?

Duhet të ndiqen masat e zakonshme të higjienës për të parandaluar përhapjen e infeksioneve: larja e rregullt e duarve, mbulimi i gojës dhe hundës kur kolliteni dhe teshtini, gatimi plotësisht i mishit dhe vezëve. Shmangni kontaktin e ngushtë me këdo që tregon simptoma të sëmundjes respiratore si kollitja dhe teshtima. (Royal Pharmaceutical Society, 2020)

A ka ndonjë bar specifik për të parandaluar ose trajtuar SARS-CoV-2?

Deri më tani, nuk ka asnjë bar specifik të rekomanduar për të parandaluar ose trajtuar SARS-CoV-2. Sidoqoftë, personat e infektuar duhet të kenë kujdesin e duhur për të lehtësuar dhe trajtuar simptomat, dhe ata me sëmundje të rëndë duhet të marrin një kujdes shëndetësor të përshtatshëm. Disa trajtime specifike janë nën hetim dhe do të testohen përmes provave klinike. OBSH po ndihmon për të përshpejtuar përpjekjet e kërkimit dhe zhvillimit me një gamë partnerësh. (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2020)

